



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

Nr. 134

Datë. 25 . 11 . 2021

VENDIM

**“PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.71 DATË
28.06.2021 PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE TË KTHYERA NË FOND BANESE TË
NDËRTUARA NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Njesia e Menaxhimit të Banesave Sociale, bazuar në nenin 9 pika 1.2, pika 1.6, 24, 54/e dhe 64 të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjin 22/2018 “Për strehimin social” dhe VKM-në 898 datë 18.11.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara” Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të Vendimit Nr.71 të Keshillit Bashkiak Korçë datë 28.06.2021 *“Për privatizimin e banesave të kthyera në fond banese të ndërtuara nga Enti Kombetar i Banesave”*
2. Lista e subjekteve përfitues nga privatizimi bashkangjitur është pjesë e këtij Vendimi.
3. Pikat e tjera të Vendimit të sipërcituar ngelen të pandryshuara.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Njesia e Menaxhimit të Banesave Sociale, në Bashkinë Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Erjon Nexhipi

